Raport krahasimor për vlerësimin institucional me nxënësit, mësuesit, prindërit dhe bizneset

Shkolla Profesionale “Kolin Gjoka” Lezhë

Viti shkollor 2025 - 2026

Shtator 2026

Tabela e përmbajtjes

Lista e Tabelave....3

Hyrje....5

Metodologjia....5

Të dhëna për pjesëmarrësit 2026....7

Rezultatet....8

- Zhvillimi i vazhduar profesional....8
- Kurrikula....9
- Marrëdhënia me biznesit....10
- Orientimi në karrierë....11
- Projektet....12
- Marketingu....13
- Gjurmimi në nivel ofruesi....14

Shtojca 1 – Tabela exel me të dhënat nga sondazhi....16

Shtojca 2 – Pyetësorët.... **Error! Bookmark not defined.**

Lista e Tabelave

Table 1: Numri i pyetësorëve të plotësuar për secilin target grup 7
Table 2: Rezultatet për treguesit e zhvillimit të vazhduar profesional 8
Table 3: Rezultatet për treguesit e kurrikulës 9
Table 4: Rezultatet për treguesit e marrëdhënieve me biznesin 10
Table 5: Rezultatet për treguesit e orientimit në karrierë 11
Table 6: Rezultatet për treguesit e projekteve 12
Table 7: Rezultatet për treguesit e marketingut 13
Table 8: Rezultatet për treguesit e gjurmimit në nivel ofruesi 14

© 2026 Swisscontact

Rreth projektit "Aftësi për Punë" (S4J)

Aftësi për Punë (S4J) është një projekt i Agjencisë Zvicerane për Zhvillim dhe Bashkëpunim (SDC) i zbatuar nga Swisscontact, i cili synon të adresojë sfidat kryesore në Arsimin dhe Formimin Profesional (AFP) në Shqipëri. Që prej tetorit 2015, projekti "Aftësi për Punë" (S4J) mbështet qeverinë dhe aktorët e tjerë të interesit për të ndërtuar një sistem cilësor të AFP në Shqipëri, i frymëzuar nga modeli zviceran. Në fazën e tij të tretë (2024-2027), me theks të veçantë tek qëndrueshmëria, projekti është angazhuar në ndarjen dhe zhvillimin e mëtejshëm të njohurive dhe përvojave të përftuara në nivel sistemi, në bashkëpunim të ngushtë me shkollat partnere.

Hyrje

Ky raport paraqet gjetjet nga procesi i **Vlerësimit Institucional** të zhvilluar në Shkollën **"Kolin Gjoka"** për vitin shkollor 2025 - 2026. Procesi, me synim vlerësimin e cilësisë së shërbimeve të aftësimit profesional, përfshiu nxënës, mësues, prindër dhe biznese partnere, të cilët u anketuan gjatë periudhës maj-qershor 2026. Ky vit shënon realizimin e procesit për të tretin vit radhazi, duke e konsoliduar si një praktikë të qëndrueshme dhe të rëndësishme për përmirësimin e cilësisë së ofrimit të shërbimeve.

Procesi u koordinua nga Njësia e Zhvillimit (NjZH) në shkollë, e cila luan një rol kyç në monitorimin dhe përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë së shërbimeve. Përshkrimi i gjetjeve në raport është i organizuar sipas treguesve për secilin funksion të NJZH-së.

Ky proces vlerësues mbështetet në përvojën e vitit shkollor 2024 - 2025, ku projekti 'Aftësi për Punë' (S4J), në bashkëpunim me gjashtë shkolla partnere[1], zhvilloi katër instrumente vlerësimi (pyetësorë), të bazuar në një metodologji rigoroze dhe pjesëmarrëse. Pas pilotimit në gjashtë shkolla, instrumentet u rishikuan për të garantuar vlefshmëri, qëndrueshmëri dhe respektim të standardeve etike[2].

Metodologjia

Në kuadër të mbledhjes së informacionit që do të ushqejë analizën vjetore të performancës institucionale, në përfundim të çdo viti shkollor do të realizohet një proces vlerësimi institucional në nivel ofruesi duke përfshirë katër grupeve kryesore: nxënës, mësues, biznese dhe prindër. Ky proces synon të vlerësojë performancën institucionale, të identifikojë fushat për përmirësim dhe të informojë objektivat e planit vjetor të institucionit.

Për këtë qëllim, janë zhvilluar katër instrumente vlerësimi (pyetësor), si vijon:

Pyetësori për nxënësit synon të mbledh mendimet dhe përvojat e nxënësve për cilësinë e shërbimeve të aftësimit profesional. Fokusohet në cilësinë e mësimdhënies, praktikën profesionale, orientimin në karrierë dhe performancën e institucionit. Qëllimi është përmirësimi i programeve për të përgatitur më mirë nxënësit për tregun e punës.

Pyetësori për mësuesit synon të mbledh mendimet dhe përvojat e mësuesve për cilësinë e shërbimeve të aftësimit profesional dhe mjedisit të të nxënit. Fokusohet në zhvillimin profesional, zbërthimin e kurrikulës, projektet zhvillimore dhe dhe performancën e institucionit. Qëllimi është identifikimi i fushave për përmirësim dhe përshtatja e praktikave me nevojat e stafit dhe nxënësve.

Pyetësori për bizneset synon të mbledh perceptimet e bizneseve për cilësinë e bashkëpunimit me institucionin dhe përvojën me nxënësit gjatë praktikës profesionale. Fokusohet në përgatitjen e nxënësve, përputhshmërinë e programeve të praktikës me nevojat e tregut të punës

[1] Hamdi Bushati, Kolin Gjoka, Kristo Isak, Shkolla Profesionale Elbasan, Shkolla Teknike Ekonomike Tirane, Tregtare.
[2] Për më shumë informacion, shih raportin Baseline i treguesve të cilësisë së Njësisë së Zhvillimit https://skillsforjobs.al/publications/baseline-i-treguesve-te-cilesise-se-njesise-se-zhvillimit/

dhe mundësitë për përmirësim. Qëllimi është forcimi i bashkëpunimit dhe angazhimi cilësor i sektorit privat në proceset e aftësimit profesional.

Pyetësori për prindërit synon të mbledhë mendimet e prindërve për cilësinë e shërbimeve të aftësimit profesional. Fokusohet në komunikimin me shkollën, orientimin në karrierë të fëmijëve dhe imazhin e institucionit. Qëllimi është përmirësimi i shërbimeve për të përmbushur pritshmëritë dhe nevojat e nxënësve dhe prindërve.

Të dhëna për pjesëmarrësit 2026

Për vitin shkollor 2025–2026, në shkollën profesionale "Kolin Gjoka" 284 nxënës morën pjesë në sondazh. Nga këta, 59,5% (N=169) ishin djem, 37,3% (N=106) ishin vajza dhe 3,2% (N=9) kanë preferuar të mos përgjigjen. Të shpërndarë sipas klasave, 19,6% (N=55) e të anketuarve janë në klasën e dhjetë, 28,5% (N=80) në klasën e njëmbëdhjetë, 33,5% (N=94) në klasën e dymbëdhjetë, 18,1% (N=51) në klasën e trembëdhjetë dhe 0,4% (N=1) në arsimin profesional pas të mesëm.

Ndërkohë, morën pjesë në anketim 14 mësues, nga ku 85.7% (N=12) janë femra dhe 14.3% (N=2) janë meshkuj. Të ndarë sipas grup lëndëve që japin mësim 7.1% (N=1) japin lëndë të teorisë profesionale, 7.1% (N=1) japin module të praktikës profesionale dhe 85.7% (N=12) japin njëkohësisht lëndë të teorisë profesionale dhe module të praktikës profesionale.

Në sondazhin për bizneset partnere të shkollës kanë marrë pjesë 93 biznese. Nga ku 98,9% (N=92) e bizneseve deklarojnë se bashkëpunojnë me shkollën përmes mbi 5 modaliteteve të ndryshme të bashkëpunimit, ndërsa 1,1% (N=1) raportojnë 1 deri në 2 modalitete bashkëpunimi. Këto të dhëna tregojnë se bashkëpunimi me bizneset partnere zhvillohet në forma të shumëllojshme

Për vitin shkollor 2025-2026 në shkollën profesionale "Kolin Gjoka", morën pjesë gjithsej 262 prindër.Nga këta, 56,1% (N=147) ishin femra, 40,5% (N=106) ishin meshkuj dhe 3,4% (N=9) kanë preferuar të mos përgjigjen. Të shpërndarë sipas klasës ku ndjek shkollën fëmija, nga 260 përgjigje të vlefshme, 19,6% (N=51) e të anketuarve kanë fëmijën në klasën e dhjetë, 26,5% (N=69) në klasën e njëmbëdhjetë, 30,0% (N=78) në klasën e dymbëdhjetë, 23,5% (N=61) në klasën e trembëdhjetë dhe 0,4% (N=1) në arsimin profesional pas të mesëm.

Table 1: Numri i pyetësorëve të plotësuar për secilin target grup

Përfituesit	**2024**	**2025**	**2026**
Nxënës	247	304	284
Mësues	26	22	14
Prindër	221	200	260
Biznese	47	42	93

Rezultatet

Seksionet më poshtë përmbledhin rezultatet e matjeve me nxënësit, mësuesit, prindërit dhe bizneset. Ndërkohë, listën e plotë të gjetjeve për cdo pyetësor e gjeni në Shtojcën 1.

Zhvillimi i vazhduar profesional

Në vitin 2026, krahasuar me vitin 2025, përputhja e aktiviteteve të ZHVP me nevojat e mësuesve ka rënë me 7,1%, ndërsa mbetet 12,1% mbi rezultatin e vitit 2024 (80,8%). Përmirësimi i aftësive të mësuesve përmes aktiviteteve të ZHVP-së ka rënë nga 100% në 85,7%, me një ndryshim prej 14,3%, ndërsa krahasuar me vitin 2024 (92,3%) është 6,6% më i ulët. Kënaqësia me mbështetjen gjatë zbatimit të planit të ZHVP-së ka kaluar nga 90,9% në 2025 në 85,7% në 2026, një rënie prej 5,2%, dhe është gjithashtu 2,8% më e ulët se në vitin 2024 (88,5%). Ndërsa aplikimi i njohurive dhe metodave të reja në mësimdhënie ka mbetur i pandryshuar në 100% në 2025 dhe 2026, duke shënuar një rritje prej 3,8% krahasuar me vitin 2024 (96,2%).

Te nxënësit, kënaqësia me metodat e mësimdhënies është rritur nga 67,8% në 2025 në 77,5% në 2026, pra me 9,7%, dhe është 2,6% më e lartë se në vitin 2024 (74,9%). Ndërsa kënaqësia me metodat e përdorura gjatë procesit mësimor u rrit me 9,7%, nga 71,4% në 2025 në 81,1% në 2026. Në të kundërt, kënaqësia me shpeshtësinë e ndërveprimit ka vijuar të ulet, nga 79,5% në 2024 në 77,7% në 2025 dhe 73,0% në 2026; pra, rezultati i vitit 2026 është 4,7% më i ulët se në 2025 dhe 6,5% më i ulët se në 2024.

Table 2: Rezultatet për treguesit e zhvillimit të vazhduar profesional

Përfitues të shërbimit	Treguesit e cilësisë	Rezultati 2024 %	Rezultati 2025 %	Rezultati 2026 %
Mësuesit e kulturës profesionale – përfitues direkt	1. Aktivitetet e ZHVP janë në përputhje me nevojat e mësuesve.	80.8	100	92.9
	2. Aftësitë e mësuesve janë përmirësuar nga trajnimet/aktivitetet e parashikuara në planin e ZHVP.	92.3	100	85.7
	3. Mësuesit janë të kënaqur me mbështetjen që kanë marrë gjatë zbatimit të planit të ZHVP.	88.5	90.9	85.7
	4. Mësuesit aplikojnë në mësimdhënie njohuritë aftësitë, shprehitë dhe metodat e reja të mësimdhënies që kanë mësuar në trajnime dhe shkëmbime.	96.2	100	100
Nxënësit – përfitues indirekt	1. Nxënësit janë të kënaqur me metodat e mësimdhënies (si p.sh., puna në grup, puna me projekte, përdorimi i teknologjisë, ndërveprimi në klasë etj.).	74.9	67.8	77.5
	2. Nxënësit janë të kënaqur me metodat e përdorura gjatë procesit të mësimdhënies.		71.4	81.1
	3. Nxënësit janë të kënaqur me shpeshtësinë e ndërveprimit gjatë procesit mësimor.	79.5	77.7	73.0

Kurrikula

Në vitin 2026, krahasuar me vitin 2025, të dy treguesit për mësuesit kanë shënuar rritje. Lehtësia në zbërthimin e kurrikulës është rritur nga 90,9% në 92,9%, pra me 2,0%, dhe është 19,8% më e lartë se në vitin 2024 (73,1%). Ndërsa kënaqësia e mësuesve me mbështetjen e koordinatorit të kurrikulës është rritur nga 77,3% në 92,9%, me 15,6%, dhe krahasuar me vitin 2024 (73,1%) është rritur me 19,8%.

Te nxënësit, kënaqësia me përshtatjen e programit mësimor me tregun e punës ka vijuar të ulet, nga 89,1% në 2024 në 80,9% në 2025 dhe 80,2% në 2026. Kjo përfaqëson një ulje prej 0,7% krahasuar me vitin 2025 dhe prej 8,9% krahasuar me vitin 2024.

Te bizneset, kënaqësia me njohuritë, aftësitë dhe shprehitë e nxënësve është rritur nga 88,1% në 2025 në 97,8% në 2026, pra me 9,7%, ndërsa krahasuar me vitin 2024 (91,5%) është rritur me 6,3%. Gjithashtu, vlerësimi i bizneseve për përshtatjen e planeve të praktikës profesionale me nevojat e tyre është rritur nga 85,7% në 2025 në 96,7% në 2026, me 11,0%, dhe krahasuar me vitin 2024 (82,6%) është rritur me 14,1%.

Table 3: Rezultatet për treguesit e kurrikulës

Përfitues të shërbimit	Treguesit e cilësisë	Rezultati 2024 %	Rezultati 2025 %	Rezultati 2026 %
Mësuesit – përfitues direkt	1. Mësuesit e kanë më të lehtë zbërthimin e kurrikulës në përputhet me nevojat rajonale të tregut të punës.	73.1	90.9	92.9
	2. Mësuesit janë të kënaqur me mbështetjen që kanë marrë nga koordinatori i kurrikulës për zbatimin e mësimdhënies	73.1	77.3	92.9
Nxënësit – përfitues indirekt	1. Nxënësit mendojnë se programi mësimor është e përshtatur me tregun e punës.	89.1	80.9	80.2
Bizneset – përfitues indirekt	1. Bizneset janë të kënaqur me njohuritë, aftësitë dhe shprehitë që kanë marrë nxënësit në shkollë.	91.5	88.1	97.8
	2. Bizneset mendojnë se planet e praktikës profesionale janë në përshtatje me nevojat e tyre.	82.6	85.7	96.7

Marrëdhënia me biznesit

Në vitin 2026, krahasuar me vitin 2025, përqindja e nxënësve që kanë bërë praktikë profesionale në biznes është rritur ndjeshëm, me 28,9%. Në të kundërt, niveli i kënaqësisë së nxënësve me mundësitë që ofron shkolla për praktikë profesionale në biznes është 1,0% më i ulët se në 2025 dhe 13,8% më i ulët se në 2024. Edhe kënaqësia me realizimin e praktikës profesionale sipas planit ka mbetur pothuajse e pandryshuar në vitet 2025–2026, duke kaluar nga 72,9% në 73,2%, pra me 0,3%, ndërsa krahasuar me vitin 2024 (87,7%) është 14,5% më e ulët.

Te bizneset, bashkëpunimi në forma të ndryshme me shkollën është rritur nga 2025 në 2026, me 2,0%, dhe krahasuar me vitin 2024 është rritur me 20,2%. Kënaqësia e bizneseve për bashkëpunimin me shkollën është rritur nga 81,6% në 2025 në 96,6% në 2026, me 15,0%, dhe është 27,0% më e lartë se në vitin 2024. Bizneset që deklarojnë se bashkëpunojnë ngushtë me shkollën kanë shënuar një rritje prej 0,5% në 2026 krahasuar me 2025 dhe prej 29,2% krahasuar me 2024.

Kënaqësia e bizneseve me cilësinë e përgatitjes së nxënësve është rritur nga 88,1% në 2025 në 97,8% në 2026, me 9,7%, dhe krahasuar me vitin 2024 është rritur me 6,3%. Vlerësimi se shkolla përmbush nevojat e biznesit për aftësi cilësore pune ka kaluar nga 97,6% në 2025 në 97,8% në 2026, me 0,2%, ndërsa krahasuar me vitin 2024 është rritur me 16,9%. Njohja e programit mësimor nga bizneset është rritur nga 95,1% në 2025 në 96,8% në 2026, me 1,7%, dhe krahasuar me vitin 2024 (61,7%) është rritur me 35,1%. Po ashtu, njohja shumë e mirë e moduleve profesionale ka kaluar nga 90,2% në 2025 në 96,6% në 2026, me 6,4%, ndërsa krahasuar me vitin 2024 (57,4%) është rritur me 39,2%.

Table 4: Rezultatet për treguesit e marrëdhënieve me biznesin

Përfitues të shërbimit	Treguesit e cilësisë	Rezultati 2024 %	Rezultati 2025 %	Rezultati 2026 %
Nxënësit – përfitues direkt	1. % e nxënësve që kanë bërë praktikë profesionale në biznes.	60.3	54.0	82.9
	2. Niveli i kënaqësisë së nxënësve me mundësitë që ofron shkolla për praktikë profesionale në biznes.	86.9	74.1	73.1
	3. Niveli i kënaqësisë së nxënësve me realizimin e praktikës profesionale në biznes sipas planit të praktikës.	87.7	72.9	73.2
Bizneset – përfitues direkt	1. Bizneset bashkëpunojnë në forma të ndryshme me shkollën.	78.7	96.9	98.9
	2. Bizneset janë të kënaqura për bashkëpunimin me shkollën.	69.6	81.6	96.6
	3. Bizneset bashkëpunojnë ngushtë me shkollën.	21.3	50	50.5

	4. Bizneset janë të kënaqur me cilësinë e përgatitjes së nxënësve nga shkolla.	91.5	88.1	97.8
	5. Bizneset mendojnë se shkolla përmbush nevojat e biznesit për aftësi cilësore pune.	80.9	97.6	97.8
	6. Biznesi njeh programin mësimor që ofron shkolla.	61.7	95.1	96.8
	7. Biznesi njeh shumë mirë modulet profesionale qe ofron shkolla.	57.4	90.2	96.6

Orientimi në karrierë

Në vitin 2026, krahasuar me vitin 2025, përqindja e nxënësve që kanë marrë shërbime të ndryshme për orientimin në karrierë është rritur me 2,0%, dhe krahasuar me vitin 2024 me 9,4%. Niveli i kënaqësisë së nxënësve me cilësinë e shërbimit të ofruar në sesionet e orientimit në karrierë është rritur nga 76,2% në 2025 në 82,1% në 2026, me 5,9%, ndërsa krahasuar me vitin 2024 mbetet 4,7% më i ulët. Informimi i nxënësve për shanset e punësimit pas diplomimit ka kaluar nga 62,4% në 2025 në 65,6% në 2026, me 3,2%, ndërsa krahasuar me vitin 2024 është 1,2% më i ulët.

Te prindërit, kënaqësia me shërbimin e orientimit në karrierë që shkolla i ofron fëmijës është rritur nga 67,4% në 2025 në 76,6% në 2026, pra me 9,2%, por mbetet 3,5% më e ulët se në vitin 2024. Ndërsa besimi i prindërve se orientimi në karrierë e ka ndihmuar fëmijën në marrjen e vendimeve për karrierën ka kaluar nga 76,1% në 2025 në 77,2% në 2026, me rritje 1,1%.

Table 5: Rezultatet për treguesit e orientimit në karrierë

Përfitues të shërbimit	Treguesit e cilësisë	Rezultati 2024 %	Rezultati 2025 %	Rezultati 2026 %
Nxënësit – përfitues direkt	1. Nxënësit kanë marrë shërbime të ndryshme për orientimin në karrierë.	82.2	89.6	91.6
	2. Nxënësit janë të kënaqur me cilësinë e shërbimit të ofruar në sesionet e orientimit në karrierë.	86.8	76.2	82.1
	3. Nxënësit janë të informuar për shanset e punësimit pas diplomimit në profilin që po studiojnë.	66.8	62.4	65.6
Prindërit – përfitues indirekt	1. Prindërit janë të kënaqur me shërbimin për orientim në karrierë që i jep shkolla fëmijës.	80.1	67.4	76.6
	2. Prindërit besojnë se orientimi në karrierë e ka ndihmuar fëmijën për të marrë vendimet e duhura për karrierën.	77.6	76.1	77.2

Projektet

Në vitin 2026, krahasuar me vitin 2025, njohja e projekteve zhvillimore nga mësuesit është rritur nga 77,3% në 92,9%, me 15,6%, ndërsa krahasuar me vitin 2024 (100%) është 7,1% më e ulët. Edhe vlerësimi se projektet zhvillimore përmirësojnë cilësinë e arsimit është rritur nga 77,3% në 92,9%, me 15,6%, por mbetet 3,3% më i ulët se në vitin 2024 (96,2%). Përfshirja e mësuesve në shkrimin e projekteve është rritur nga 45,5% në 50,0%, me 4,5%, ndërsa përfshirja në zbatimin e tyre është rritur nga 31,8% në 50,0%, me 18,2%.

Te nxënësit, njohja e projekteve zhvillimore ka rënë nga 76,0% në 2025 në 65,5% në 2026, me 10,5%, dhe është 4,9% më e ulët se në vitin 2024. Përfshirja në projekte ka rënë nga 61,6% në 2025 në 49,4% në 2026, me 12,2%, por mbetet 24,7% më e lartë se në vitin 2024. Ndërsa kënaqësia me përfshirjen në aktivitetet e projekteve është rritur nga 63,5% në 69,0%, me 5,5%, dhe kënaqësia me rezultatet e projekteve është rritur nga 67,5% në 81,0%, me 13,5%.

Table 6: Rezultatet për treguesit e projekteve

Përfitues të shërbimit	Treguesit e cilësisë	Rezultati 2024 %	Rezultati 2025 %	Rezultati 2026 %
Mësuesit – përfitues direkt	1. Mësuesit i njohin projektet zhvillimore të shkollës	100.0	77.3	92.9
	2. Mësuesit mendojnë se projektet zhvillimore të shkollës përmirësojnë cilësinë e arsimit	96.2	77.3	92.9
	3. Mësuesit janë të përfshirë në shkrimin e projekteve zhvillimore si pjesë e grupeve të punës	19.2	45.5	50.0*
	4. Mësuesit janë të përfshirë zbatimin e projekteve zhvillimore.	34.6	31.8	
Nxënësit – përfitues direkt	1. Nxënësit janë të dijeni të projekteve zhvillimore në shkollë.	70.4	76.0	65.5
	2. Nxënësit janë të përfshirë në projekte zhvillimore	24.7	61.6	49.4
	3. Nxënësit janë të kënaqur me përfshirjen në aktivitete të projekteve të zhvilluara nga shkolla.	86.7	63.5	69.0
	4. Nxënësit janë të kënaqur me rezultatet e projekteve të zbatuara nga shkolla.	85.4	67.5	81.0

Shënim: *Treguesit 3 dhe 4 janë llogaritur vetëm për mësuesit që raportuan pjesëmarrje në grupet e punës për projektet zhvillimore (N=7; 50% e kampionit total të shkollës).

Marketingu

Në vitin 2026, kënaqësia e mësuesve me aktivitetet e planit të marketingut ka rënë nga 90,5% në 2025 në 85,7% në 2026, pra me 4,8%, por mbetet 9,7% më e lartë se në 2024. Vlerësimi i cilësisë së materialeve informuese ka rënë nga 95,5% në 2025 në 76,9% në 2026, me 18,6%, ndërsa krahasuar me 2024 (88,5%) është 11,6% më i ulët. Kënaqësia e mësuesve me imazhin e shkollës është rritur nga 77,3% në 2025 në 85,7% në 2026, me 8,4%. Përfshirja e mësuesve në aktivitetet e marketingut ka mbetur e pandryshuar në 85,7% në 2025 dhe 2026, ndërsa krahasuar me 2024 (38,5%) është rritur me 47,2%.

Te nxënësit, kënaqësia me aktivitetet e marketingut ka rënë nga 66,3% në 2025 në 34,8% në 2026, me 31,5%, ndërsa krahasuar me 2024 është 32,0% më e ulët. Vlerësimi i cilësisë së informacionit në materialet e marketingut ka rënë nga 80,9% në 2025 në 59,5% në 2026, me 21,4%, dhe është 27,0% më i ulët se në 2024. Kënaqësia me imazhin e shkollës është rritur me 1,2%, në 2026, ndërsa përfshirja në aktivitetet e marketingut ka rënë me 1,3% në 2026,.

Te bizneset, vlerësimi i shkollës si institucion me reputacion/imazh të mirë është rritur nga 2025 në 2026, me 2,6%, ndërsa krahasuar me 2024 është rritur me 10,6%. Te prindërit, vlerësimi i shkollës si institucion me imazh të mirë është rritur nga 2025 në 2026, me 0,6%, por krahasuar me 2024 është 5,4% më i ulët.

Table 7: Rezultatet për treguesit e marketingut

Përfitues të shërbimit	Treguesit e cilësisë	Rezultati 2024 %	Rezultati 2025 %	Rezultati 2026 %
Mësuesit – përfitues indirekt	1. Mësuesit janë të kënaqur me aktivitetet e planit të marketingut të shkollës.	76.0	90.5	85.7
	2. Mësuesit mendojnë se materialet informuese për marketingun janë cilësore	88.5	95.5	76.9
	3. Mësuesit janë të kënaqur me imazhi që ka shkollë	80.8	77.3	85.7
	4. Mësuesit ndihen të përfshirë në aktivitetet e marketingut të shkollës.	38.5	85.7	85.7
Nxënësit – përfitues indirekt	1. Nxënësit janë të kënaqur me aktivitetet e marketingut të shkollës	66.8	66.3	34.8
	2. Nxënësit mendojnë se informacioni i dhënë në materialet e marketingut është cilësor.	86.5	80.9	59.5
	3. Nxënësit janë të kënaqur me imazhit të shkollës.	74.1	72.3	73.5

	4. Nxënësit ndihen të përfshirë në aktivitetet e marketingut.	31.1	36.1	34.8
Bizneset – përfitues indirekt	1. Bizneset e vlerësojnë shkollën si institucion me reputacion/ imazh të mirë.	87.2	95.2	97.8
Prindërit – përfitues indirekt	1. Prindërit e nxënësve të shkollës dhe nxënësve të klasave të 8-9 vlerësojnë shkollën si institucion me imazh të mirë.	74.5	68.5	69.1

Gjurmimi në nivel ofruesi

Në vitin 2026, përdorimi i të dhënave të gjurmimit nga drejtuesit dhe mësuesit për përmirësimin e procesit mësimor dhe aktiviteteve të lidhura me të është rritur nga 2025 me 5,9% në 2026, si dhe krahasuar me vitin 2024 është rritur me 13,2%. Po ashtu, përdorimi i të dhënave të gjurmimit për përmirësimin e aktivitetit vjetor të shkollës është rritur nga 2025 me 2,0% në 2026, ndërsa krahasuar me vitin 2024 është rritur me 19,8%.

Table 8: Rezultatet për treguesit e gjurmimit në nivel ofruesi

Përfitues të shërbimit	Treguesit e cilësisë	Rezultati 2024 %	Rezultati 2025 %	Rezultati 2026 %
Drejtuesi dhe Mësuesit – përfitues direkt	1. Drejtuesit dhe mësuesit përdorin të dhënat e gjurmimit për të përmirësuar procesin mësimor dhe aktivitetet e lidhura me të.	65.4	72.7	78.6
	2. Shkolla i përdor të dhënat e gjurmimit për përmirësimin e aktivitetit vjetor	73.1	90.9	92.9

Rekomandime për forcimin institucional

Rekomandimet e mëposhtme lidhen drejtpërdrejt me gjetjet e raportit për shkollën “Kolin Gjoka”. Për treguesit e mësuesve, krahasimet duhen interpretuar duke marrë parasysh pjesëmarrjen e 14 mësuesve në 2026, nga 22 në 2025.

1. Marketing më i përshtatur me nevojat e nxënësve

Materialet informuese dhe aktivitetet e marketingut të rishikohen me kontributin e nxënësve, për të kuptuar çfarë informacioni u nevojitet dhe cilat forma komunikimi janë më të dobishme. Nxënësve t’u jepen role konkrete në përgatitjen dhe realizimin e aktiviteteve.

Gjetja: Kënaqësia e nxënësve me aktivitetet e marketingut ra nga 66.3% në 34.8%, ndërsa vlerësimi i cilësisë së informacionit nga 80.9% në 59.5%. Edhe te mësuesit, vlerësimi i cilësisë së materialeve ra nga 95.5% në 76.9%. Vetëm 34.8% e nxënësve ndihen të përfshirë në aktivitetet e marketingut.

2. Të kuptohet përvoja e nxënësve gjatë praktikës

Pas çdo periudhe praktike të mblidhen mendimet e nxënësve për detyrat, mbështetjen nga mentorët dhe realizimin e planit. Gjetjet të diskutohen me bizneset pritëse për të përcaktuar përmirësimet e nevojshme.

Gjetja: Përqindja e nxënësve që kanë kryer praktikë në biznes u rrit nga 54.0% në 82.9%, por kënaqësia me mundësitë e praktikës mbetet 73.1% dhe me realizimin sipas planit 73.2%, kundrejt përkatësisht 86.9% dhe 87.7% në 2024. Ndërkohë, 96.7% e bizneseve i vlerësojnë planet e praktikës si të përshtatura me nevojat e tyre. Dallimi mes vlerësimeve kërkon diskutim me të dy grupet.

3. Më shumë mundësi për përfshirjen e nxënësve në projekte

Projektet në zbatim të prezantohen rregullisht në klasa, duke sqaruar qëllimin, aktivitetet dhe mënyrat e pjesëmarrjes. Përfshirja të shtrihet te më shumë nxënës, duke u mbështetur në përvojat dhe rezultatet që pjesëmarrësit i vlerësojnë pozitivisht.

Gjetja: Njohja e projekteve nga nxënësit ra nga 76.0% në 65.5%, ndërsa përfshirja nga 61.6% në 49.4%. Në të njëjtën kohë, kënaqësia me rezultatet e projekteve u rrit nga 67.5% në 81.0%, duke sugjeruar nevojën për ta zgjeruar pjesëmarrjen.

4. Orientim në karrierë me informacion më konkret për punësimin

Sesionet e orientimit të përfshijnë informacion të përditësuar për mundësitë e punësimit sipas profilit, kërkesat e bizneseve dhe rrugët e vijimit të studimeve. Të përdoren gjetjet e gjurmimit dhe takimet me të diplomuar e punëdhënës për t'i ndihmuar nxënësit të vlerësojnë alternativat e tyre.

Gjetja: Megjithëse 91.6% e nxënësve kanë marrë shërbime orientimi dhe 82.1% janë të kënaqur me cilësinë e tyre, vetëm 65.6% ndihen të informuar për shanset e punësimit pas diplomimit në profilin që studiojnë.

5. Më shumë ndërveprim gjatë mësimit

Njësia e Zhvillimit të diskutojë me nxënësit dhe mësuesit se si mund të shtohen mundësitë për pyetje, diskutime dhe pjesëmarrje aktive në klasë. Shkëmbimet mes mësuesve të fokusohen te praktikat që përfshijnë më gjerësisht nxënësit.

Gjetja: Kënaqësia e nxënësve me shpeshtësinë e ndërveprimit në mësim ka rënë nga 79.5% në 2024 në 77.7% në 2025 dhe 73.0% në 2026. Kjo ndodh ndërkohë që kënaqësia me metodat e mësimdhënies është rritur nga 67.8% në 77.5% dhe të gjithë mësuesit që iu përgjigjën treguesit raportojnë zbatimin e njohurive dhe metodave të fituara në trajnime.

Shtojca 1 – Tabela exel me të dhënat nga sondazhi

Shkolla Kolin Gjoka_Indeksi.xlsx